



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 242, datë 20.12.2018

PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 149 e vijues dhe nenit 246 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Analiza e gjendjes financiare e shoqërisë “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a. më 30.09.2018 është kryer mbi bazën e pasqyrave financiare të raportuara nga shoqëria, si dhe mbi bazën e të dhënave shtesë, të kërkuara kësaj shoqërie nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Referuar konkluzioneve të analizës financiare rezultojnë se:

Vonesa në depozitim në AMF në formë shkresore dhe në formë elektronike të formularit “Llogaritja ditore e normës së likuiditetit”, përkatësisht për muajin korrik 2018 për 37 dhe 30 ditë, për muajin gusht 6 ditë (vetëm për raporimin në formë shkresore) dhe për muajin shtator 3 dhe 2 ditë, kundrejt afatit të përcaktuar në nenin 9 të Rregullores së Autoritetit nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”.

Mungesa të politikave të shkruara në lidhje me transaksionet dhe marrëdhëniet me palët e lidhura si dhe procedurat për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit sipas përcaktimeve të nenit 23 të Ligjit 52/14.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Bazuar në nenin 23, pika 5), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, shoqëria e sigurimit “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a., duhet të ketë procedura për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të cilat duhet të përfshijnë informimin për konfliktin e mundshëm të interesit, kërkesa të veçanta për transaksionet që duhet të kryhen, në përputhje me kërkesat e këtij neni.
2. Afati për depozitimin në Autoritet, në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të jetë brenda datës 28.02.2019.
3. Bazuar në nenin 246, pika 4), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të sanksionohet me gjobë në masën 100,000 lekë, personi përgjegjës i shoqërisë “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a., për mosraportim në përputhje me kërkesat e nenit 85, pika 1, germa ë) të Ligjit 52/2014 si dhe të Rregullores nr. 56, datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”.
4. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI